



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 307 Prot.

Tiranë, më 01.03.2018

VENDIM Nr. 27, datë 21.02.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Informacionin mbi potencialin arkeologjik të zonës ku do të zhvillohet projekti "*Godinë banimi dhe shërbimesh 5 kat*", në rrugën "*Anastas Durrsaku*" në zonë arkeologjike "*B*" Durrës- subjekti "JEDAS" sh.p.k. dhe Konceptin e sondazheve arkeologjike, të paraqitur paraprakisht nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e sondazheve arkeologjike, të paraqitur paraprakisht nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k., me kushtin e reduktimit të tyre, në pesë sondazhe gjithsej. Koncepti me numrin e reduktuar të sondazheve të depozitohet pranë ASHA.
2. Subjekti "JEDAS" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR,
MIRELA KUMBARO EURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO